

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6957  
E martë, 1 gusht 2023  
Çmimi 0.40 €

Me urdhër të Speciales,  
arrestohet në Tiranë  
ish-luftëtari i UÇK-së  
Dritan Goxhaj | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## GAZETARËT PROTESTOJNË NË MBËSHTETJE TË KLAN KOSOVËS | FAQE 4-5



Gazetarë, kameramanë, fotoreporterë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile protestuan të hënën në sheshin "Zahir Pajaziti" deri te ndërtesa e Qeverisë së Kosovës. Protesta me moton "Demokracia

vdes në errësirë" u mbajt në shenjë kundërshtimi për vendimin e pezullimit të certifikatës së biznesit Klan Kosova nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, një vendim politik i

qeverisë Kurti që është goditje ndaj medias dhe fjalës së lirë në Kosovë. Gjithashtu, me anë të kësaj proteste u kërkua nga gjykata ta trajtojë rastin e Klan Kosovës në mënyrë të drejtë dhe pa u ndikuar

SENATI  
I UP-SË E  
MIRATOI  
STATUTIN  
E RI | FAQE 7



HARADINAJ:  
ËSHTË  
URGJENCË  
KOMBËTARE  
QË KJO QEVERI  
DEGRADUESE  
SA MË PARË TË  
LARGOHET | FAQE 5



### AKTUALE



HYN NË FUQI MARRËVESHJA  
KUFITARE NË MES TË SHQIPËRISË  
DHE MAQEDONISË SË VERIUT | F. 2

NAFTËTARËT KUNDËRSHTOJNË  
MASAT MBROJTËSE TË QEVERISË | F. 7

40 TË VDEKUR E MBI 7 000  
QYTETARË U LËNDUAN NË  
AKSIDENTE TRAFIKU NGA JANARI  
DERI NË QERSHOR | F. 7

### EKONOMI



FRIGORIFERË NËPËR RRUÇËT E  
EVROPËS PËR TA PARANDALUAR  
PRISHJEN E USHQIMIT | F. 8

HYN NË FUQI RREGULLORJA  
PËR PËRFSHIRJEN E TË GJITHË  
QYTETARËVE NË TREGUN  
FINANCIAR | F. 6

### SPORT



KRASNIQI: DO T'JU BËJ KRENAR  
SECILIN PREJ JUSH | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Hyn në fuqi marrëveshja kufitare në mes të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 31 KORRIK - Një marrëveshje në mes të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për kontrollimin e përbashkët të pikave kufitare mes dy vendeve ka hyrë në fuqi të hënën më 31 korrik. Në pikën kufitare në juglindje të Shqipërisë, Qafë-Thanë, do të ketë vetëm një pikë ndalese, e cila do ta lehtësojë lëvizjen e qytetarëve dhe mallrave. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe homologu i tij maqedonas, Dimitar Kovaçevski, inspektuan pikën kufitare të Qafë-Thanës, ku u prezantua nisma "One stop shop" (një ndalesë, një kontroll) mes dy vendeve. Të dy kryeministrat vlerësuan se lehtësitë në qarkullimin e njerëzve dhe mallrave vijnë "si rezultat i Ballkanit të hapur".

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovaçevski, tha se dy vendet "janë shembull se si duhet të sillen dy shtete fqinje", ndërsa theksoi se mes gjithë vendeve të Ballkanit nuk duhet të ketë kufij. "Lehtësojmë punën e 11 kompanive maqedonase eksportuese, mundësojmë qasje më të mirë në portet e Shqipërisë, por edhe në destinacionet turistike në dy vendet. Falë 'Ballkanit të hapur' është rritur për 40 % shkëmbimi tregtar me Shqipërinë dhe 50 % në raport me Serbinë", tha Kovaçevski. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se kjo nismë duhet të vijojë më tej drejt lëvizjes së lirë dhe kontrollit të rastësishëm të automjeteve. "Shpresoj që Ministrinë e Brendshme (të dy vendeve) do



të kalojnë në një tjetër nivel në këtë periudhë piku të sezonit dhe në sezonet e tjera verore,

për të bërë kalimin pa kontroll, apo më saktë me kontroll të rastësishëm të makinave, në

mënyrë që të lehtësohet edhe më shumë qarkullimi", tha Rama.

## Mjekët paralajmërojnë për probleme shëndetësore afatgjatë pas tërmetit në Turqi

ANKARA, 31 KORRIK - Gjysmë viti nga tërmeti shkatërrues në Turqinë jugore, Shoqata e Mjekëve e këtij shteti ka paralajmëruar për dëme shëndetësore afatgjatë. Tërmeti 7.8 ballësh e goditi Turqinë juglindore më 6 shkurt të këtij viti, duke shkatërruar shkatërrim të madh. Dridhja fillestare u përcoll nga një seri dridhjesh të tjera. Dhjetëra mijëra njerëz u vranë dhe miliona të tjerë mbetën pa shtëpi. Tani rrënojat janë hequr pothuajse plotësisht, por problemet shëndetësore afatgjatë po vazhdojnë, ka thënë për DPA Selahattin Montes, kryetar i Shoqatës së Mjekëve në qytetin Adana në jug të Turqisë. Gratë dhe fëmijët janë posaçërisht në rrezik, tha ai. Ka mungesë të të ushqyerit të



baraspeshuar, i cili mund të shkaktojë çrregullime në zhvillim të fëmijët. Në rrezik

janë edhe gratë shtatzëna. "Një numër i madh i lindjeve të parakohshme dhe abortimeve

janë vërejtur në këtë rajon", theksoi Montes. Operacione të vështira duhet të

kryen në Adana dhe spitalet atje janë të mbingarkuara tashmë. Mjekët në këtë rajon të Turqisë kanë vërejtur edhe një rritje në depresion. "Ka pasur shumë vdekje, njerëzit kanë humbur gjithçka dhe jeta që ata kanë tani u ofron pak atyre", shtoi ai. Ai i akuzoi autoritetet se i kanë hedhur në mënyrë të pakontrolluar rrënojat nga ndërtesat e rrëzuara. Ata nuk e dinin nëse ato përmbanin toksinë, si asbest, dhe nëse ato do të depërtonin deri në tokën ujore. Ai tha se mungesa e këtyre njohurive është telash i madh. "Ne nuk e dimë se si do të jetë shkalla e kancerit të mushkërive në pesë apo 10 vjetët e ardhshme, ashtu siç nuk e dimë se si ushqyerja e dobët do të ndikojë në zhvillimin e fëmijëve", përfundoi ai.

## Më shumë se 700 000 fëmijë ukrainas u dërguan në Rusi, sipas Moskës

MOSKË, 31 KORRIK - Më shumë se 700 000 fëmijë ukrainas janë dërguar nga Ukraina në Rusi që kur filloi pushtimi rus i Ukrainës, ka thënë të hënën Maria Lvova-Belova, komisionare për të drejtat e fëmijëve e Rosisë. Në një raport të publikuar më 30 korrik, Lvova-Belova tha se shumica e këtyre fëmijëve erdhën në Rusi "të shoqëruar nga prindërit apo të afërmit e vet". Më 17 mars Gjykata

Ndërkombëtare Penale lëshoi urdhër arrestim për presidentin e Rosisë, Vladimir Putin, dhe për Lvova-Belovan. Ata akuzohen se janë përgjegjës për dëbimin e fëmijëve ukrainas drejt Rosisë – që është krim luftë sipas të drejtës ndërkombëtare. Sipas të dhënave zyrtare të autoriteteve ukrainase më 31 korrik 2023, që nga 24 shkurti 2022, 19 546 fëmijë janë dërguar nga Ukraina në Rusi.

Këto janë rastet e vetme të regjistruara zyrtarisht, kur një prind, kujdestar apo dëshmitar i dëbimit të fëmijës, e ka raportuar rastin në zyrën shtetërore për informim të Ukrainës. Aktivistët ukrainas për të drejtat e njeriut ngulin këmbë se qindra mijëra fëmijë janë zhvendosur detyrimisht nga Ukraina. Shumica e fëmijëve janë marrë nga rajonet e Mariupolit, Hersonit, Harkivit dhe Kievit.



# Naftëtarët kundërshtojnë masat mbrojtëse të qeverisë

Prishtinë, 31 korrik - Shoqata e Naftëtarëve e Kosovës i ka kundërshtuar masat mbrojtëse që qeveria ka vendosur për produktet e naftës. Kreu i kësaj shoqate, Fadil Berjani, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se vendimi i 28 korrikut i autoriteteve të Kosovës është bazuar në inspektimin e disa kompanive që, sipas tij, "po abuzojnë me çmimin e naftës" andaj, sipas Berjanit, vendimet e tilla "po dëmtojnë të gjithë sektorin". Më 28 korrik Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) vendosi caktimin e çmimit tavan dhe masave të tjera mbrojtëse për produktet e naftës. Sipas këtij vendimi, marzha maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është 2 centë për litër, ndërkaq tavan i lejuar për shitjen me

pakicë është 12 centë për litër. Vendimi do të jetë në fuqi për një muaj. "Ky vendim është i dëmshëm për bizneset sepse me marzhën prej 12 centësh për pakicë është e vështirë të mbijetohet. Lus kryeministrin [e Kosovës, Albin] Kurti që të anulojë këtë vendim të gabuar", thotë Berjani. MINT tha se vendimi është marrë bazuar në monitorimin e çmimeve në tregun e produkteve të naftës, "evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës, si dhe raportet e përditshme nga Inspektorati i Tregut lidhur me çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës, me ç'rast është evidentuar një rritje e çmimeve e cila nuk reflektohet nga lëvizjet e çmimeve në tregun botëror." Megjithatë, Berjani tha se nëse



ka kompani që "manipulojnë dhe abuzojnë me çmime në dëm të qytetarëve, atëherë me to duhet të merren organet relevante e jo të dëmtohen

kompanitë që janë korrekte në shërbim të qytetarëve dhe me çmime reale". Ai paralajmëroi se për vendimin e fundit të MINT-it, Shoqata e

Naftëtarëve do t'u drejtohet organeve të drejtësisë. Aktualisht, çmimi mesatar i një litri naftë në Kosovë është 1.45 euro.

## Haradinaj: Është urgjencë kombëtare që kjo qeveri degraduese sa më parë të largohet



Prishtinë, 31 korrik - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka bashkëbiseduar të

hënën me përfaqësues të sektorit nga ekonomia, sektorit privat dhe bizneset si punëdhënësit më të mëdhenj në vend, në kuadër të

ciklit të diskutimeve me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm.

Në këtë tryezë Haradinaj ka

shprehur vlerësimin e lartë për sektorin privat si shtyllë e zhvillimit të vendit dhe adresimit të problemit kryesor - punësimit.

"Ishte dakordim i përbashkët që klima për zhvillimin ekonomik dhe të bërit është përkeqësuar skajshmërisht gjatë kësaj qeverie. Jostabiliteti politik, mungesa e një oferte konkrete për investime të huaja, procedurat e shumta burokratike, bllokimi i investimeve kapitale dhe qasja ndëshkuese dhe armiqësore e qeverisë ndaj sektorit privat, e ka sjellë ekonominë buzë kolapsit", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se AAK-ja qëndron fuqishëm krah sipërmarrësve. "Ne besojmë se sektori privat si kontribuuesi më i madh në arkën e shtetit dhe rritjen e punësimit, meriton trajtim të veçantë. Ne besojmë që është urgjencë kombëtare që kjo qeveri degraduese sa më parë të largohet në mënyrë që Kosova t'i kthehet prosperitetit dhe zhvillimit ekonomik", ka deklaruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

## Me urdhër të Speciales, arrestohet në Tiranë ish-luftëtari i UÇK-së Dritan Goxhaj

Prishtinë, 31 korrik - Me urdhër të Gjykatës Speciale është arrestuar ish-luftëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dritan Goxhaj. Ai është arrestuar në Tiranë dhe ndodhet në ambientet e Drejtorisë së Policisë. Specialja ka thënë se arrestimi ka ndodhur në lidhje me veprat kundër administrimit të drejtësisë që përfshijnë frikësimin dhe pengimin e personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

"Më 31 korrik 2023 autoritetet shqiptare arrestuan Dritan Goxhaj në Tiranë. DhSK kërkoi bashkëpunimin dhe ndihmën e autoriteteve shqiptare për arrestimin e z. Goxhaj dhe dorëzimin e tij në KSK në bazë të një urdhër-arresti të lëshuar nga një gjyqtar i DhSK-së në lidhje me veprat kundër administrimit të drejtësisë që përfshijnë frikësimin dhe pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Goxhaj do

të mbahet në Shqipëri në pritje të një vendimi nga autoritetet shqiptare për transferimin e Goxhaj në ambientet e paraburgimit të DhSK në Hagë", ka thënë Anglea Griep, shefe për Informim dhe Komunikim me Publikun në Dhomat e Specializuara të Kosovës. Ai është djali i ish-zëvendëshefit të Shtabit të UÇK-së dhe kolonelit të njohur nga Shqipëria, Dilaver Goxhaj.





## Gazetarët protestojnë në mbështetje të Klan Kosovës

Gazetarë, kameramanë, fotoreporterë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile protestuan të hënën në sheshin “Zahir Pajaziti” deri te ndërtesa e Qeverisë së Kosovës. Protesta me moton “Demokracia vdes në errësirë” u mbajt në shenjë kundërshtimi për vendimin e pezullimit të certifikatës së biznesit Klan Kosova nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, një vendim politik i qeverisë Kurti që është goditje ndaj medias dhe fjalës së lirë në Kosovë. Gjithashtu, me anë të kësaj proteste u kërkua nga gjykata ta trajtojë rastin e Klan Kosovës në mënyrë të drejtë dhe pa u ndikuar

Ky vendim i ARBK-së riktheu në fuqi masën e pezullimit të certifikatës së biznesit të televizionit privat më 22 qershor.

Klan Kosova u ankua menjëherë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, i cili më 28 korrik vendosi t’ia hedhë poshtë

ankesën dhe ta konfirmojë përfundimisht pezullimin e certifikatës së biznesit të saj, duke theksuar se ARBK-ja kishte “vepruar në përputhje me ligjin kur e pezulloi certifikatën e biznesit të Klan Kosovës”.

MINT-i e akuzon televizionin se e “ka shkelur Kushtetutën e

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 31 KORRIK** - Gazetarët e Kosovës protestuan të hënën në përkrahje të televizionit Klan Kosova në Prishtinë pas vendimit të Ministrisë së Industrisë për t’ia pezulluar licencën e biznesit këtij televizion javën e kaluar. Duke e mbajtur një pllakatë të gjerë në dorë, me mbishkrimin “Demokracia vdes në errësirë”, dhe duke fishkëllyer vazhdimisht, gazetarët marshuan nga sheshi “Zahir Pajaziti” deri tek ai “Skënderbeu” në kryeqytet. Disa medime i vendosën në tokë pajisjet e tyre të punës, si kamerat, tripodet dhe mikrofonat, për t’u solidarizuar

me televizionin Klan Kosova. Më 28 korrik Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) e hodhi poshtë ankesën e Klan Kosovës për shfuqizimin e pezullimit të certifikatës së biznesit saj. MINT-i kishte ngritur fillimisht kallëzim penal ndaj Klan Kosovës më 14 qershor, me pretendimin se në certifikatën e biznesit, te ndërimi i pronarëve, figuron “Pejë - Serbia dhe Gjakovë - Serbia”. Pas kësaj, Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) ia anuloi certifikatën e biznesit Klan Kosovës para se ta shfuqizonte vendimin më 21 qershor. Megjithatë, një ditë më vonë ARBK-ja anuloi vendimin e 21 qershorit.



# Senati i UP-së e miratoi statutin e ri

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 KORRIK - Senati i Universitetit të Prishtinës ka miratuar të hënën statutin e ri të universitetit, i cili ishte propozuar, pas konsultimeve të brendshme, nga grupi i punës, të cilin e themeloi Këshilli Drejtues dhe i njëjti ishte miratuar njëzëri nga ky këshill.

Sipas njoftimit të UP-së, statuti i ri reflekton ngritje substanciale të standardeve të funksionimit si institucion dhe avancim të standardeve akademike. "Këto ndryshime vijnë pas më tepër se njëmbëdhjetë (11) vjetësh, kur për herë të fundit statuti është rishikuar, ndryshuar e plotësuar. Marrë parasysh përmbajtjen dhe shpejtësinë, me të cilën kanë lëvizur dinamikat dhe trendet në arsimin e lartë, status quo-ja ka qenë zgjidhje qartazi e paqëndrueshme dhe ndryshimet të ngutshme e të domosdoshme. Në dimensionin strukturor, statuti parasheh një funksion më të decentralizuar të universitetit, duke bartur e saktësuar përgjegjësitë dhe llogaridhënien menaxheriale drejt rektorit dhe dekanëve, ndërsa në anën tjetër parasheh edhe rol më të fuqizuar akademik të senatit dhe këshillave të njësisë akademike. Statuti përcakton rregulla që avancojnë aspiratat për barazi gjinore, synojnë të rrisin kriteret për zgjedhje në pozita drejtuese dhe përmbajnë ndalesa për periudha të konsiderueshme kohore për personat, të cilët ushtrojnë ose kanë ushtruar funksione të larta partiake apo politike dhe synojnë pozita drejtuese në universitet", ka njoftuar UP-ja.

Më tej theksohet se në dimensionin praktik, statuti avokon një frymë të re të vlerësimit të vazhdueshëm të punës së studentëve, në anën tjetër reflekton edhe kërkesën për një

identitet më të zgjeruar profesional të personelit akademik, ku detyrat e punës shkojnë përtej mësimdhënies dhe përtej synimeve legjitime për marrjen e thirrjeve akademike, duke përcaktuar kriteret më të sakta e objektivisht të matshme, duke krijuar një ekuilibër të kujdesshëm midis thirrjeve të ndryshme dhe duke i afuar ato më pranë kriterëve që e vendosin universitetin më afër universiteteve partnere në Evropë e më gjerë. "Në mënyrë të veçantë, kjo shprehet edhe me krijimin e bazës së konsoliduar rregullative për institute dhe qendra hulumtuese funksionale (në nivel universiteti apo njësisë akademike), që kanë një autonomi të gjerë të veprimit buxhetor e administrativ;

skemave mbështetëse për punën e tyre dhe përfshirjen aktive të personelit akademik në zbatim të projekteve, si dhe krijimin e pozitave të reja për hulumtues universitarë, që rrisin kapacitetin dhe fuqinë kërkimore të universitetit. Këto rregullime ndjekin modelet e universiteteve me të mira botërore, të cilat UP-ja i aspiron. Me statutin e ri, universiteti reflekton qartë koherencën me politikën dhe parimet e ENQA-s për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ndërsa parashihet edhe politika të reja për vlerësim dhe menaxhim të performancës së personelit akademik", theksohet në njoftim. Studimet e strukturuar pasdoktorale, lejimi i formave moderne të mësimdhënies si mësimi online apo ai i kombinuar, fuqizimi i mekanizmave shtesë për të drejtat e studentëve si p.sh.: krijimi i institucionit të Ombudspersonit, si dhe fuqizimi i rolit të studentëve në vlerësimin e performancës së stafit akademik janë disa nga politikën e reja që sjell miratimi i këtij statuti. "Në dimensionin e standardeve të



avancimeve akademike, statuti parasheh një ngritje të dukshme të kërkesave për avancimet akademike të personelit, ndërsa në anën tjetër parasheh edhe lehtësime administrative që personeli akademik të mos e shohë procesin e avancimit apo rizgjedhjes si proces të imponuar. Statuti parasheh standarde më rigorozë, ndonëse më të sakta dhe qartazi proporcionale, për marrjen e thirrjes së parë të profesorit (zgjedhja në profesor asistent) dhe në marrjen e thirrjes së fundit (profesor i rregullt). Standarde të tilla i janë dashur Kosovës në mënyrë që të rritet produktiviteti shkencor, të rritet cilësia e publikimeve shkencore dhe në këtë mënyrë të përmirësohet gjendja në rangimin e universitetit dhe Kosovës në nivel rajoni dhe më gjerë", është bërë me dije në njoftimin e UP-së.

Në njoftim thuhet se ky statut paraqet një standard të ri të funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, ku e bën UP-në më mirë të pozicionuar ndaj sfidave mbizotëruese të kohës dhe më reaguese ndaj realiteteve të ndryshueshme shpejt, përfshirë këtu trendin e rënies konstante të numrit të studentëve, si dhe e përaftron atë me universitetet përtej vendeve fqinje. "UP-ja ka çdo arsye të besojë dhe potencial të materializojë ambicien krejtësisht legjitime të një institucioni të lartë të dijes që, jo vetëm krahasohet në rrafshin e standardeve e të fuqisë kërkimore dhe akademike, por edhe konkurron në terma seriozë me institucionet homologe në rajonin e gjerë dhe në kontinent. Matjet e fundit ndërkombëtare kanë dëshmuar potencialin për një premtim të tillë të arritshëm.

Prandaj, përkundëjt sfidave, duke gjetur inspirim në talentin e jashtëzakonshëm të komunitetit studentor dhe dedikimin e anëtarëve të komunitetit akademik, statuti i ri ofron një bazë të mirë dhe momentum të ri për të vazhduar përpjekjet e palëkundura për, siç thuhet në dispozitën e nenit të ri 5 të statutit, përmbushjen e misionit të universitetit si një 'qendër e ekselencës dhe inovacionit', që "ndërvepron me zhvillimet shoqërore dhe globale në funksion të zhvillimit të vlerave të dakorduara të shoqërisë", si dhe 'zhvillimit të demokracisë, ekonomisë së vendit dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare', ka theksuar UP-ja. Statuti i ri është votuar nga senati pas një diskutimi të gjatë e shterues dhe pa asnjë votë kundër të anëtarëve të pranishëm, pas miratimit njëzëri në Këshillin Drejtues.

Kosovës" duke i "paraqitur dy qytete të Kosovës, Pejën dhe Gjakovën, si pjesë të Serbisë" në dokumentet e regjistrimit të kompanisë. "Vetë fakti që përfaqësuesit e Klan Kosovës sh.p.k., pas kaq shumë vitesh, kanë nisur hapa për korrigjim, vërteton se biznesi në fjalë e kishte kryer shkeljen e konstatuar nga ARBK-ja dhe se vendimi për pezullimin e certifikatës së biznesit ishte marrë me të drejtë", thuhej në njoftimin e MINT-it më 28 korrik.

Klan Kosova i ka mohuar akuzat dhe i ka quajtur gabim teknik lëshimet në dokumentet e regjistrimit. "Pavarësisht se Klan Kosova SH.P.K. ka ndërmarrë hapat e rregullimit të dokumentacionit sipas udhëzimeve të MINT për ta përmirësuar çështjen teknike në regjistrim, vendimi i Komisionit është refuzues dhe, si i tillë, arbitrar dhe i papranueshëm për shoqëritë demokratike dhe shtetet ligjore", thuhet në njoftimin e Klan Kosovës. Ministria përsëriti të hënën,

ditën e protestës, se komisioni i saj e ka mbyllur këtë çështje, pra do ta mbajë në fuqi pezullimin e licencës së biznesit të televizionit, por konfirmoi se Klan Kosova gëzon të drejtën për të parashtruar padi në gjykatën kompetente. "Çdo palë në procedurë gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të ARBK-së, mirëpo shkeljet e Kushtetutës nuk mund të konsiderohen kurrë si çështje teknike", tha MINT të hënën. Por, vendimi i Ministrisë së Industrisë ka ngjallur reagime të shumta brenda dhe jashtë vendit.

Ambasada e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e Britanisë së Madhe, e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në Kosovë kanë shprehur shqetësim "shumë të thellë" me vendimin e MINT-it për ta konfirmuar pezullimin e licencës së biznesit të televizionit Klan Kosova.

Derisa presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka duke kërkuar që çështja e licencës së televizionit të bëhet "duke zbatuar ligjin, pa



ndërhyrje, bazuar në parimet e paanshmërisë dhe integritetit", kryeministri Albin Kurti e ka mbrojtur vendimin, duke thënë se "zbatimi i ligjit kundër

biznesmenëve që e shkelin atë për përfitime financiare nuk nënkupton sulm ndaj lirisë së mediejeve." Juristja e së drejtës së medias në Prishtinë, Flutura Kusari, ka thënë

se Lëvizja Vetëvendosje, kryeministri Albin Kurti dhe ministrja Rozeta Hajdari "kanë marrë vendim politik për ta mbyllur Klan Kosovën".

## Alban Zeka emërohet drejtor i Inspeksionit në komunën e Podujevës

PODUJEVË, 31 KORRIK - Me vendim të kryetarit të komunës, Shpejtim Bulliqi, të hënën është emëruar drejtor i Inspeksionit, Alban Zeka.

Alban Zeka ka përfunduar

studimet në Universitetin e Prishtinës - drejtimi Sociologji, gjithashtu ka mbaruar edhe studimet e magistraturës në këtë drejtim. I ka 10 vjet përvojë punë profesor në

Gjimnazin "Aleksandër Xhuvani". Është i martuar dhe ka një fëmijë. Kryetari Bulliqi i ka uruar suksese drejtorit Zeka në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.



## Hyn në fuqi rregullorja për përfshirjen e të gjithë qytetarëve në tregun financiar

PRISHTINË, 31 KORRIK - Banka Qendrore e Kosovës ka njoftuar se bordi i saj më 20 dhjetor 2022 ka miratuar rregulloren për qasjen në llogari pagese me shërbime bazike e cila hyn në fuqi më 1 gusht 2023, me përjashtim të nenit 5, paragrafit 4, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2024.

Rregullorja për qasjen në llogari pagese me shërbime bazike ka për qëllim t'i përcaktojë kushtet për qasjen e konsumatorëve në llogari pagese me shërbime bazike. Në njoftim theksohet se

qëllimi i BQK-së është që përmes kësaj rregulloreje t'u mundësojë të gjithë qytetarëve të marrin përfitimet që sjell tregu financiar, të kontribuojë në rritjen e përfshirjes financiare, si dhe ta nxitë pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në sektorin financiar. "Rregullorja është hartuar me qëllim të harmonizimit të legjislacionit të BQK-së me direktivat e BE-së, në këtë rast me Direktivën e BE-së 2014/92/EU. Rregullorja u mundëson të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa

marrë parasysh rrethanat financiare të tyre, statusin e punësimit apo nivelin e të ardhurave, që të mund të kenë qasje në llogari pagese me shërbime bazike. Rregullorja për qasjen në llogari pagese me shërbime bazike aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja, që veprojnë në Republikën e Kosovës. Të gjitha bankat që operojnë në Kosovë do t'u ofrojnë qasje në llogari pagese me shërbime bazike të gjithë qytetarëve të Kosovës" ka njoftuar BQK-ja.



## Vazhdon asfaltimi i rrugëve në Prizren

Prizren, 31 korrik - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka njoftuar se janë asfaltuar rrugët "Masar Shala" dhe "Nexhat Fanaj" në lagjen "Bajram Curri". Totaj ka thënë se paraprakisht

është investuar në infrastrukturën nëntokësore si vendosja e gypave të rinj të ujësjellësit, kanalizimit dhe vendosja e kablove elektrike. "Ndërkohë po punohet në shtigjet e këmbësorëve

(trotualet), ku do të vendoset edhe ndriçimi publik, gjëra të cilat e kompletojnë këtë projekt të rëndësishëm për banorët e kësaj pjese të Prizrenit", ka shkruar Totaj në "Facebook".

## Nxënësit e fshatit Vranidoll do të bëhen me objekt të ri shkollor



PRISHTINË, 31 KORRIK - Nxënësit e fshatit Vranidoll gjysmëvjetorin e parë të vitit të ri shkollor do ta presin në objektin e ri të shkollës, i cili është duke u ndërtuar me ritme të shpejta. Kështu ka bërë me dije kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Ai ka

thënë se kjo shkollë do ta ketë një ndërtesë të re me kushte shumë më të mira infrastrukturore. "Kjo shkollë do të jetë shtëpia e dytë për shumë nxënës të zonës, e cila do t'i presë me shumë ngrohtësi", ka shkruar Rama në "Facebook".

## Sekuestrohen tri armë dhe një sasi narkotikësh në Prishtinë

PRISHTINË, 31 KORRIK - Njësi për Reagim të Shpejtë (NjRSh) në Prishtinë, me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të veprave

kriminale, po vazhdon kontrollet rutinë të automjeteve në lokacione të ndryshme. Zyrarët e NjRSh-së gjatë

fundjavës në pika kontrolli kanë gjetur dhe sekuestruar tri armë si dhe një sasi të narkotikëve të llojit marijuanë.

Personat e dyshuar janë shoqëruar në stacionet përkatëse dhe ndaj tyre janë kryer procedurat e nevojshme policore.



## Konjufca vlerëson përkrahjen e vazhdueshme të Belgjikës dhënë Kosovës

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim shefin e zyrës belge në Kosovë, Julien Sassel, me të cilin ka biseduar për raportet dypalëshe, zhvillimet aktuale politike në vend e rajon dhe mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit të ndërsjellë. Konjufca vlerësoi marrëdhëniet e mira

dypalëshe dhe përkrahjen e vazhdueshme që Belgjika i ka dhënë ndër vite Republikës së Kosovës në proceset e shtetndërtimit, zhvillimit dhe integritit euroatlantik. Shefi i zyrës belge, Julien Sassel, e falënderoi kryetarin e Kuvendit për pritjen dhe shprehu gatishmërinë e shtetit belg për vazhdimin e mbështetjes së Kosovës, me

theks të veçantë në proceset nëpër të cilat po kalon shteti ynë.

Në takim, ndër të tjera, u ritheksua përkushtimi dhe gatishmëria e dyanshme për thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës.



## Kosova me qindra zjarrfikës mangët

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ulja e temperaturave dhe reshjet e dendura të shiut më 26 korrik ishin një ndihmesë për zjarrfikësit që ta parandalonin përhapjen e disa vatrave të zjarrit në komunën e Prishtinës, atë të Obiliqit dhe të Fushë-Kosovës. "Kemi pasur dhjetë zjarre fushore. Në zjarre fushore hyjnë zjarret e hamulloreve, barit të thatë... Është numër i lartë por, për fat, gjatë natës ka pasur disa reshje shiu", thotë Malë Gashi, ushtrues i detyrës së komandantit të brigadës profesionale të zjarrfikëseve dhe shpëtimit, që i mbulon këto komuna.

Kjo brigadë, sipas tij, operon me vetëm 80 zjarrfikës - numër i pamjaftueshëm për nevojat e popullatës në këto rajone.

Gashi thotë se brigada ka nevojë edhe për së paku 65 zjarrfikës të tjerë.

Ditët e fundit Kosova është përballur me temperatura të larta - mbi 37 gradë celsius. Me rritjen e temperaturave rritet shpesh edhe rreziku për ndezjen dhe përhapjen e zjarreve.

Pothuajse çdo vit ka vatra zjarresh në pjesët malore, por edhe djegie të arave pas korrijës së të mbjellave. Për këtë arsye, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave u ka bërë thirrje qytetarëve të jenë të kujdesshëm dhe t'i shmangin të gjithë shkaktarët e mundshëm të zjarreve.

Në një thirrje të lëshuar më 18 korrik, kjo agjenci ka kërkuar nga qytetarët që, në rast se vërejnë ndonjë zjar, ta paraqesin atë në numrat emergjentë.

Muharrem Beka, kryetar i



Sindikates së Zjarrfikëseve të Kosovës, thotë se menaxhimi dhe parandalimi i përhapjes së zjarreve paraqet shqetësim për të për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zjarrfikësve. Në nivel vendi, sipas tij, janë rreth 800 zjarrfikës - kapacitete këto të pamjaftueshme për t'u përballur me ndonjë katastrofë natyrore apo me vatra të mëdha të zjarreve. Ai konsideron se në bazë të numrit të përgjithshëm të popullatës, rreth 1.8 milion Kosovës i nevojiten edhe 400 zjarrfikës.

Në bazë të rregullores për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit, për çdo 1 500 banorë nevojitet së paku një zjarrfikës.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, Kosova duhet të ketë rreth 1 200 zjarrfikës.

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave në vend nuk iu përgjigj interesimit të REL-it rreth numrit të zjarrfikësve, përkatësisht sa është i mjaftueshëm ai.

Tahir Ahmeti, drejtor ekzekutiv në Qendrën Kërkimore për

Politika të Sigurisë, thotë se zjarrfikësit janë reaguesit e parë në rast të çfarëdo fatkeqësie natyrore dhe, për këtë arsye, rritja e numrit të tyre do të duhej të ishte prioritet për institucionet kompetente. "Kur jemi te fatkeqësitë natyrore apo zjarret, duhet që çdoherë të jemi të përgatitur, sepse shteti apo institucionet nuk mund t'i parandalojnë fatkeqësitë natyrore, mirëpo duhet të jenë të përgatitura", thotë Ahmeti për "Radion Evropa e Lirë".

Zjarrfikësit në Kosovë punojnë pa sigurime shëndetësore, ndërsa paga e tyre bazë është 520 euro. Për shkak të temperaturave të larta, në javët e fundit zjarret në Mesdhe kanë shkaktuar vdekjen e mbi 40 personave. Në luftë të ashpër me to ka qenë sidomos Greqia, ku dhjetëra mijëra njerëz janë detyruar të zhvendosen nga shtëpitë. Për valën ekstreme të të nxehtit në Evropën jugore - në disa vende mbi 44 gradë celsius - janë fajësuar sidomos ndryshimet klimatike.

## 40 të vdekur e mbi 7 000 qytetarë u lënduan në aksidente trafiku nga janari deri në qershor

PRISHTINË, 31 KORRIK - Që nga janari e deri në qershor, 40 persona kanë humbur jetën në aksidente trafiku, ndërsa mbi 7 000 qytetarë kanë pësuar lëndime trupore për gjatë kësaj periudhe kohore. Policia e Kosovës në një përgjigje për Telegrafin ka bërë me dije se për gjashtë muaj kanë ndodhur 35 aksidente fatale, ku 40 persona kanë humbur jetën.

Gjatë kësaj kohe numri i aksidenteve me persona të lënduar është 3 0782, ku janë lënduar gjithsej 7 247 qytetarë, kurse tiketa trafiku janë shqiptuar 309 403. Sa i përket të dhënave për muajin korrik, policia ka njoftuar se ende nuk kanë numrin e plotë. Por, vlen të ceket se gjatë kësaj kohe ka ndodhur numër i madh i aksidenteve trafiku, ku

shumë prej tyre ishin me fatalitet.

Vetëm në 24 orët e fundit policia njoftoi se kanë ndodhur 46 aksidente trafiku me persona të lënduar, ndërsa 54 të tjerë raportohet të kenë qenë vetëm me dëme materiale.

Policia në vazhdimësi është duke bërë thirrje që qytetarët t'i respektojnë rregullat e komunikacionit.



# Dyqanet në veri të Kosovës pa prodhime të Serbisë

**PRISHTINË, 31 KORRIK** - Për herë të parë në periudhën e pasluftës në Mitrovicën e Veriut, komunë me shumicë serbe në veri të Kosovës, pothuajse nuk ka prodhime nga Serbia. Mungesë e këtyre produkteve vërehet edhe në komunat e tjera të Kosovës. Këtë e dëshmojnë për "Radion Evropa e Lirë" qytetarët dhe afaristët, ndërkaq kjo mund të konstatohet edhe nga raftet e dyqaneve, ku janë të renditura kryesisht prodhime nga vendet e rajonit.

Një nga afaristët nga Mitrovica e Veriut, i cili këmbënguli të mbetet anonim, shpjegon se qumështi "Imlek" nga Serbia është zëvendësuar me "Bimilk" nga Maqedonia e Veriut dhe në vend të ushqimit të ngrirë "Frikom", po ashtu nga Serbia, në ofertë është "Ledo" nga Kroacia.

"Na u desh të riorientoheshim dhe të blinim mallra që janë në dispozicion me shumicë. Po gjendemi ashtu siç na imponohet. 'Bimlek' nga Manastiri (nga Maqedonia e Veriut) është i njëjtë me 'Imlek'

(nga Serbia), ndërsa produktet 'Swisslion' nga Serbia i zëvendësojmë me të njëjtat produkte që vijnë nga Maqedonia e Veriut", thotë ky biznesmen.

"Bimilk" është pjesë e kompanisë rajonale "Imlek" me seli në Serbi, e cila operon edhe në Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë dhe në Maqedoninë e Veriut.

Mungesa e produkteve serbe në veri të Kosovës është pasojë e vendimit të Qeverisë së Kosovës më 14 qershor për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia. Ky vendim pasoi me arrestimin e tre pjesëtarëve të Policisë së Kosovës nga forcat serbe, për të cilët autoritetet në Prishtinë thanë se u "rëmbyen". Siç ishte paralajmëruar, një vendim i tillë është marrë për arsye sigurie dhe jo ekonomike dhe nuk dihet se sa do të qëndrojë në fuqi.

Kjo nuk është hera e parë që autoritetet e Kosovës marrin vendim për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia apo vendosjen e taksave për to, por deri më tani janë përdorur të



ashtuquajturat "rrugë alternative" në veri të Kosovës për import.

Policia e Kosovës në bashkëpunim me Doganën gjatë vitit të fundit kanë zhvilluar disa aksione kundër kontrabandës me mallra, ndërsa "rrugët alternative" ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë janë nën kontroll të rreptë të Policisë së Kosovës.

Rasti i fundit ishte javën e kaluar në Leposaviq, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të vendit, kur Policia e Kosovës ndaloi një automjet me targa të Serbisë, të cilin e drejtonte një

shtetas serb.

"Gjatë kontrollimit në automjet janë vërejtur pije alkoolike (verë) rreth 100 litra, si dhe pemë e perime", thuhet në raportin e Policisë së Kosovës të datës 26 korrik.

Automjeti me ngarkesën është dërguar në terminalin doganor.

## Frigoriferë nëpër rrugët e Evropës për ta parandaluar prishjen e ushqimit

**PRISHTINË, 31 KORRIK** - Koka e marules me të cilën ke harruar të bësh sallatë ka nisur të thahet? Keni blerë shumë ushqime para se të niseni për pushime?

Në përpjekje e sipër për t'iu ndihmuar konsumatorëve miqësorë me natyrën, një kompani joqeveritare në Gjenevë është duke e shtuar numrin e frigoriferëve në ambiente publike, me mundësinë që restaurantet, apo banorët e tjerë që gatuajnë në shtëpi, të mund t'i mbushin me ushqimet që mund t'u prishen, raporton AP.

Ky hap është pjesë e një përpjekjeje edhe më të madhe nga komunitetet në Zvicër, dhe disa shtete të tjera evropiane që të kontribuojnë në mbrojtje të natyrës përmes shmangies së prishjes së ushqimit.

Kompania joqeveritare Free-Go - emri i së cilës rrjedh nga 'frigo', fjalë e përdorur nga shumë shtete për frigoriferin - i ka shpërndarë disa pajisje të tilla nëpër Gjenevë, kryesisht në vendet ku këmbësorët mund të marrin falas pemë, perime, bukë, kroasantë dhe ushqime të tjera.

Programi kushton rreth 40 000 dollarë në vit dhe gëzon mbështetjen e shumë grupeve bamirëse dhe qeverisë lokale.

Projekti është prezantuar vitin e kaluar me vetëm një frigorifer jashtë një qendre komuniteti në perëndim të Gjenevës, dhe tani i



ka katër të tillë, të shpërndarë në mënyrë strategjike rreth qytetit. I pesti pritet të vendoset në qytet deri në fund të vitit.

Marine Delevaux, drejtoreshë e projektit, ka thënë se ushqimi i depozituar zhduket fluturimthi brenda një ore.

Për arsye shëndetësore dhe të rregulloreve të tjera, aty nuk lejohet të dërgohen ushqime të ngrira, të hapura, gjella të përgatitura, apo alkool.

Free-Go është duke eksperimentuar edhe me vizita nëpër disa ndërtesa banesore për t'ua lehtësuar banorëve pjesëmarrjen në program. Ajo e ka krijuar edhe një linjë telefonike, përmes së cilës punëtorët e restoranteve mund

ta kontaktojnë organizatën për ushqimin e papërdorur. "Në përgjithësi, kur mblidhet ushqimi nga dyqanet dhe restaurantet në mëngjes, njerëzit mezi presin t'i marrin ato", ka thënë Delevaux, duke shtuar se frigoriferi i parë në Gjenevë ka kontribuar në ruajtjen e rreth 3.2 tonëve të ushqimit.

Prej sasisë totale të ushqimit të dhuruar, vetëm rreth 3 për qind nuk është konsumuar.

Free-Go ka thënë se kontribuuesit e ushqimit nga sektori privat - sikurse restaurantet apo shitësit e tjerë - duhet të zotohen se ushqimi i dhuruar është i sigurt për t'u ngrënë.

Ligji zviceran thotë se ushqimi

pas "datës së rekomanduar të përdorimit" mund të konsumohet deri në një vit më pas, ka thënë Delevaux.

Qeveria zvicerane vlerëson se gati një e treta e të gjitha produkteve ushqimore për konsum përfundon të shportë të mbeturinave - apo rreth 330 kilogramë për person çdo vit.

Free-Go vlerëson se një miliard ton me ushqime përfundojnë duke u prishur çdo vit në botë, ndonëse për krijimin e tyre është përdorur energji dhe burime të tjera në prodhim dhe transportim. "Shpërdorimi i ushqimit nuk është vetëm çështje etike dhe ekonomike por, gjithashtu, e shkatërron mjedisin me burime të

kufizuara natyrore", ka thënë Komisioni Evropian.

Fushata të ngjashme për ruajtje të ushqimit janë duke u zbatuar edhe në Bern, pasi ideja është importuar nga Gjermania.

Sipas Foodsharing.de, grup në Gjermani që e ka jetësuar këtë ide më shumë se një dekadë më parë, më shumë se gjysmë milioni njerëz në Gjermani, Francë dhe Austri e kanë kthyer iniciativën në lëvizje ndërkombëtare dhe kanë ndihmuar në ruajtjen e 83 milionë tonëve të ushqimit, duke e parandaluar prishjen.

Për shkak që ushqimi është falas, donacionet ndryshojnë nga dita në ditë dhe disa konsumatorë çasti mund të përfundojnë të zhgënjyer.

Shala Moradi, 65-vjeçare nga Irani, që jeton në Gjenevë që një dekadë, ka thënë se ka qenë në kërkim të bukës, por nuk ka pasur. Megjithatë, ajo e vlerëson iniciativën. "Është shumë e mirë. Mund të marrë dredhëza, qershi, produkte të ngjashme. Pjesa që janë falas, më pëlqen po ashtu", ka thënë ajo.

Ndërkohë, Severine Cuendet, mësuese 54-vjeçare, që e ka oborrin e mbushur me perime, ka thënë se dërgon ushqime vazhdimisht, sepse "ka shumë" dhe e ka duartrokatur iniciativën, "sepse kjo lagje ka shumë nevojë". "Kjo na ndodh të gjithëve neve që blejmë shumë", ka thënë ajo e buzëqeshur.



# Misteri i pazgjidhur i gjuhës më të vjetër të Evropës



Nga Tim BRINKHOF

Nëse nuk jeni lindur dhe rritur në Spanjë, ka shumë mundësi të keni mësuar për herë të parë për Vendin Bask përmes leximit të romanit të Ernest Hemingway të vitit 1926 “Dhe dielli lind përsëri”, i cili përshkruan jetën e një grupi njerëzish që i përkasin të ashtuquajturit “Brezi i Humbur”, të cilët udhëtojnë nëpër Evropën Perëndimore pas Luftës së Parë Botërore.

Hemingway-t i pëlqente shumë Vendi Bask sepse njerëzit atje ishin me karakter të fortë ndërsa historia e tyre ishte tragjike. Të ndodhur midis Spanjës Veriore dhe Francës Jugore, baskët kanë luftuar për liri që kur u aneksuan nga Spanja në shekullin XVI-të.

Gjatë Luftës Civile Spanjolle, Francisco Franco e çoi këtë konflikt në nivele të reja kur ndaloi gjuhën baskë, pezulloi të drejtat e këtij komuniteti etnik dhe kur bombardoi qytetin bask Guernica, duke nxitur Pablo Picasson të krijonte pikturën e tij të famshme.

Këtu, politika është e ndërthurur ngushtësisht me gjuhën. Kjo gjuhë, e quajtur

Euskara, nuk tingëllon aspak si spanjishtja (gracias = eskerrik asko), dhe as që i ngjan frëngjishtes. Në fakt, Euskara është në thelb aq shumë ndryshe nga fqinjët e saj, sa që gjuhëtarët dyshojnë nëse e ka origjinën edhe nga indo-evropianishtja, familja e gjuhëve që lindi islandishten, rusishten, hindu dhe pothuajse gjithçka midis.

Origjina e Euskara është një mister që ende nuk është zgjidhur. Shumë studiues janë marrë me këtë çështje gjatë viteve, secili duke dalë me shpjegime të ndryshme. Është sugjeruar se Euskara është një paraardhëse dhe një e mbijetuar e iberisë, një gjuhë jo-indo-evropiane e folur në Gadishullin Iberik përpara se të mbërrinin romakët.

Po ashtu, Euskara ka qenë gjithashtu e lidhur me një numër gjuhësh të folura në Kaukaz, si dhe me Berberët Saharanë, një grup etnik para-arab nga Afrika Veriore. Deri vonë, besohej se baskët vinin nga një popullsi relikte paleolitike e paprekur nga emigrimet parahistorike që formuan pjesën tjetër të Evropës, gjë që shpjegon edhe arsyen pse Euskara nuk ka ngjashmëri me gjuhët romane dhe gjermanike.

Por kjo hipotezë është hedhur poshtë nga kërkimet e fundit gjenetike, të cilat tregojnë se Vendi Bask nuk ishte i izoluar kulturalisht nga shoqëritë e tjera evropiane deri shumë më vonë, gjatë pushtimit romak dhe islamik të Gadishullit Iberik. Ndërsa fryma e pavarur e baskëve, kontribuoi padyshim në izolimin e tyre, faktori përcaktues duket se ka qenë vetë gjeografia e tij.

I mbrojtur nga malet e Gjirit të Biskajës dhe Pirenejtë, terreni i thyer i largoi të huajt po aq lehtë sa i pengoi vendasit të largohen nga andej. Dhe gjenetika vetëm sa e ka bërë më të çuditshme historinë e Euskaras. Por nëse baskët kanë në një farë mënyre lidhje me indo-evropianët, pse nuk është e tillë gjuha e tyre?

Tani për tani, ne thjesht nuk e dimë këtë gjë. Veçantia e gjuhës Euskara, ka bërë që qeveritë qendrore në Spanjës dhe Francë t'i shohin baskët si një kërcënim për hegjemoninë e tyre politike, një kërcënim që është përdorur për të justifikuar diskriminimin, marginalizimin dhe persekutimin e tyre.

Gjatë Revolucionit Francez, gjuha u gjykua si nxitëse e katolicizmit, dhe për këtë arsye një armike e

Iluminizmit. Në Spanjën e Francos, ajo u cilësua zyrtarisht si armike e Zotit. Shtypja e baskëve vazhdoi edhe pas Francos. Në vitin 2003, Egunkaria, e vetmja gazetë e botuar plotësisht në gjuhën Euskara, u mbyll nga qeveria spanjolle, pasi botuesit e saj u akuzuan për komplot me grupin e dhunshëm separatist bask ETA.

Gazetarët e saj u arrestuan, u burgosën dhe thuhet se u torturuan. Kjo ngjarje nxiti kritika të forta nga organizatat dhe aktivistët e të drejtave të njeriut, përfshirë Amnesty International dhe shkrimtarin e njohur Salman Rushdie. Por akuzat për torturë nuk u hetuan kurrë. Në fund gazetaret u liruan nga akuzat ndërsa mbyllja u anulua.

Që nga ajo kohë qeveria spanjolle krijoi një identitet të veçantë të baskëve, dhe i ka dhënë rajonit një autonomi të rëndësishme ekonomike dhe politike, lëshime që pritet ende të ndodhin në anën franceze të kufirit. Shekujt e persekutimit, kanë shkaktuar ndikimin e tyre në kulturën Euskara dhe Baske në përgjithësi.


Dikur gjuha Euskara flitej në një zonë që shtrihej nga Bilbao në Barcelonë. Gati e shfarosur nga Franco, kjo gjuhë u

rikuperua disi pas vdekjes së tij në vitin 1975. Dikur ishte e ndaluar nga përdorimi publik, tani flitet në televizion, art dhe media. Në të gjithë Vendin Bask, tabelat e rrugëve janë të shkruara në Euskara, ndonjëherë krahas përkthimeve në spanjisht, ndonjëherë jo.

Më parë, Letërsia baske ishte e rrezikuar deri në atë pikë sa që sot një koleksionisti të vetëm – Edward Spencer Dodgson – i njihet merita për ruajtjen e kanunit letrar të një shoqërie të tërë, e cila aktualisht po përjeton një rilindje. Një nga librat më të famshëm në këtë gjuhë “Martutene” i Ramon Saizarbitoria, i përkthyer së fundmi në anglisht, eksploron marrëdhënien e ndërlikuar midis besnikërisë afektive ndaj një grupi dhe angazhimit të vetëdijshëm ndaj një kauze abstrakte, dy lajtmotive të historisë baske.

Në retrospektivë, përpjekja e Francisco rancos për të shkatërruar gjuhën Euskara ndihmoi në sigurimin e mbijetesës së saj. Tek e fundit, nën sundimin e tij gjuha u bë jo thjesht një mjet komunikimi, por një simbol i rezistencës kundër shtypjes. / “Big Think” – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Krasniqi: Do t'ju bëj krenar secilin prej jush



### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 31 KORRIK** - Boksieri i suksesshëm shqiptar Robin Haxhi Krasniqi është duke u përgatitur maksimalisht për meçin më special dhe më emocionues në karrierën e tij. Boksieri junikas do të boksojë për herë të parë në vendlindjen e tij, në Kosovë, pasi bëri karrierë të bujshme në Evropë dhe në botë, duke u shpallur edhe kampion i botës në boks profesionist. Krasniqi më 5 gusht do ta zhvillojë meçin e radhës në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Boksieri kampion në "Facebook" i ka falënderuar të gjithë për mbështetjen që po ia

japin para meçit të 5 gushtit. Ai nuk ka hezituar të bëjë një premtim të madh për tifozët shqiptarë, të cilët do të ndjekin me kënaqësi të madhe të shtunën që vjen, disa mijëra në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë e të tjerët përmes ekranit televiziv. "Ju faleminderit nga zemra të gjithëve për përkrahjen e madhe! Unë, biri yt Kosovë, do të bëj krenar vendin tim dhe do t'ju bëj krenar më 5 gusht secilin prej jush. Ju pres që të përjetoni nga afër emocionet, adrenalinën dhe kënaqësinë që do të ofrojë ky event", ka shkruar Krasniqi, i cili më pas bëri me dije se biletat për ta parë nga afër këtë meç mund të gjenden online tek @ravetravel.

## Sinani paraqitet te Prishtina: Do ta ndjekim titullin e kampionit

### "Epoka e re"


**PRISHTINË, 31 KORRIK** - Qendërmbrojtësi me përvojë, Egzon Sinani, e ka pranuar ofertën e skuadrës së Prishtinës duke iu bashkëngjitur kryeqytetasve në përgatitjet që po i zhvillon në Pogradec. 29-vjeçari ka luajtur për Llapin dhe Ballkanin në të kaluarën, kurse edicionin e fundit

ishte pjesë e Gjilanit. Sinani ka thënë se bashkë me Prishtinën do ta ndjekin titullin e kampionit në Superligë. "Prishtina është klubi më i trofeshëm, me kushtet më të mira dhe nuk e pata të vështirë ta pranoja ofertën për t'u veshur 'bardhekaltër', pavarësisht se në vitet e kaluara nuk ishin krijuar kushtet dhe rrethanat që më herët t'i bashkohesha skuadrës. Besoj shumë se minimumi i minimumit

të synimit do të jetë pjesëmarrja në garat ndërkombëtare. Por, duke e parë ekipin nga afër se çfarë ka, jam i bindur që do ta ndjekim edhe titullin. Kemi grup jashtëzakonisht të mirë futbollistësh, por më së shumti më gëzon fakti që shumica e futbollistëve janë të rinj dhe po shoh shumë entuziazëm të madh në grup", ka thënë Sinani për faqen zyrtare të Klubit të Prishtinës.



## Mediet turke: Rrahmani shumë shpejt zyrtarizohet te Rapidi i Bukureshtit



**Suharekë, 31 korrik** - Sulmuesi Albion Rrahmani pritet që karrierën ta vazhdojë në Rumani. Mediet rumune raportojnë se sulmuesi aktual i Ballkanit do t'i bashkohet Rapidit të Bukureshtit. Forma e mirë e Rrahmanit me fanellën e Ballkanit ka rënë në sytë e klubeve të huaja, por më i suksesshëm në garë për futbollistët ka dalë klubi rumun.

Sipas mediumit "Fanatik.ro", Ballkani do t'i përfitojë plot 600 mijë euro nga shitja e Rrahmanit, një shifër rekorde kjo për futbollin e Kosovës. "Dan Sucu ka paguar 600 mijë euro. Rrahmani vjen në Rapid dhe zyrtarizimi bëhet pas një jave. Duke qenë kosovar është më e vështirë që me atë pasaportë të hysh në Rumani. Njoftimi zyrtar

ende mungon, por lajmi është 100 për qind i saktë. Rrahmani është sulmuesi i ri i Rapidit për 600 mijë euro", ka deklaruar gazetari i këtij mediumi, Horia Ivanoviq. Ndeshja me Larnen në Ligën e Konferencës mund të jetë e fundit e Rrahmanit në fanellën e Ballkanit, me të cilin i realizoi 30 gola dhe i bëri 8 asistime në sezonin e fundit.

## Trajnerët e Kosovës përfundojnë kursin me sukses në Turqi

**PRISHTINË, 31 KORRIK** - Katër trajnerë potencialë nga Kosova kanë qëndruar në Stamboll të Turqisë. Vizita e trajnerëve potencialë kosovarë, Nderim Januzaj, Arta Mustafa, Butrint Bajraktari dhe Arsim Berisha, është bërë në kuadër të projektit të Fondit për Zhvillim të Gjeneratave të Reja (YDF) në FIBA Europe ku marrin pjesë shtetet si Kosova, Turqia, Bullgaria

Maqedonia Veriore dhe Rumania. Kjo është edhe një mbështetje nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) për trajnerët vendorë, edukimin dhe zhvillimin e tyre. Trajnerët kosovarë, së bashku me ata bullgarë, rumunë dhe maqedonas, kanë pasur mundësi që për gjashtë ditë t'i vizitojnë klubet më të mëdha turke, por edhe të marrin pjesë në seancat e tyre

stërvitore, në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë njohuri bazike rreth basketbollit. Po ashtu, këta trajnerë kanë ndjekur seminarin e basketbollit. Qëllimi i këtij projekti të FIBA Europe është shkëmbimi i përvojave të shteteve pjesëmarrëse, bashkëveprimi kulturor, ndërtimi i marrëdhënieve dhe fuqizimi i raporteve ndërmjet partnerëve.



## Bayerni, gati të thyejë rekordin e transferimeve për Kanen

MÜNCHEN, 31 KORRIK - Bayern München është gati ta thyejë rekordin e tyre të transferimeve për të nënshkruar me Harry Kane. Transferimi rekord i Bayernit është Lucas Hernandez, për të cilin klubi gjerman pagoi 80 milionë euro

në vitin 2019, raporton "Sky Sports". Ata janë të përgatitur të paguajnë më shumë se kaq për Kanen edhe pse ai ka vetëm 12 muaj nga kontrata e tij. Shefi ekzekutiv Jan-Christian Dreesen dhe drejtori teknik Marco Neppë mbërritën në

aeroportin e Mynihut të hënën në mëngjes për të fluturuar për në Angli. Klubet do të takoheshin javën e kaluar, por ai takim u ndryshua, ndërsa dialogu ka mbetur i hapur mes dy palëve për të ardhmen e kapitenit të Anglisë, Harry

Kane. Ende ekziston një hendek në vlerësim midis Bayernit dhe "Spurs"-iy, por Kane mbetet i hapur për të folur zyrtarisht me klubin gjerman nëse "Spurs" është i kënaqur që është një marrëveshje e mirë.



## Parisi bëhet gati të presë 13 milionë njerëz verën e ardhshme

PARIS, 31 KORRIK - Përpara Kullës Eifel është vendosur një orë, që numëron mbrapsht deri te çelja e Lojërave Olimpikë Verore të Parisit. Unazat olimpikë janë vendosur tashmë para bashkisë. Lojërat Olimpikë Verore 2024 do të fillojnë pas një viti në kryeqytetin francez dhe përgatitjet janë duke ecur mirë. Organizatorët kryen kohët e fundit një provë teknike për ceremoninë e hapjes në lumin e Senës. Tridhjetë e nëntë varka, të cilat do të transportojnë atletët vitin e ardhshëm, morën pjesë në provat teknike. Ishte misioni i parë i madh logjistik për të lundruar në pjesën prej gjashtë kilometrash të lumit dhe për t'i zgjidhur problemet që mund të dalin, raporton Zëri i Amerikës. Të paktën 600 000 njerëz pritet ta shikojnë ceremoninë nga brigjet e lumit. "Mësuam se teknikisht është e realizueshme. Kontrolluam shpejtësinë dhe distancat mes varkave për t'u siguruar që televizioni të jetë në gjendje të transmetojë në kushte shumë të mira ceremoninë e hapjes. Kemi ende për të bërë prova të tjera, për skenarë të ndryshëm, nëse do të ketë ndonjë problem me varkat, apo ndonjë gjë tjetër e paparashikuar në ditën e ceremonisë së hapjes", thotë Tony Estanguet, shefi i Lojërave Olimpikë të Parisit 2024.



Shefi i Policisë së Parisit, Laurent Nunez, thotë se ngjarja do të jetë e sigurt. "Ne do të kemi një sistem të jashtëzakonshëm sigurie me një numër të madh forcash. Do të mobilizohen dhjetëra mijëra forca për ta siguruar ceremoninë në lumë dhe veçanërisht përgjatë brigjeve. Do të ketë një perimetër mbrojtjeje. Vetëm ata që kanë lidhje me ceremoninë do të pranohen. Të gjithë do të kontrollohen". Sipas një raporti të Asamblesë Kombëtare Franceze, më shumë se 13 milionë njerëz pritet të shikojnë në Lojërat Olimpikë të Parisit. Organizatorët po sigurohen që infrastruktura e qytetit të jetë në gjendje të përballojë një rritje të tillë të vizitorëve. Hotelet, restorantet dhe dyqanet në kryeqytetin francez pritet të përfitojnë ekonomikisht nga ngjarja. Sipas Qendrës Franceze të Drejtësisë dhe Ekonomisë

Sportive, turizmi i lidhur me Lojërat Olimpikë mund të sjellë nga 1.6 deri 3.9 miliardë dollarë. Kapaciteti i transportit publik do të rritet 15 % dhe një linjë metroje do të zgjatet deri në aeroportin Orly. Për transportin në aeroport pritet të ketë edhe taksi fluturuese. Kompania gjermane Volocity bashkëpunoi me autoritetet franceze për të vënë në dispozicion Volokopterit e saj në pesë linja, duke përfshirë një mes aeroportit Charles de Gaulle dhe fshatit Olimpik. Muajin e kaluar policia franceze kontrolloi selinë e organizatorëve të Lojërave Olimpikë në Paris si pjesë e hetimeve për korrupsion në kontratat e lidhura me Lojërat. Është hera e tretë radhazi që akuzat për rryshfet vazhdojnë në Lojërat Olimpikë Verore. Lojërat Olimpikë Verore të Parisit do të zhvillohen nga 26 korriku deri më 11 gusht të vitit 2024.

## Suarezi: Messi dhe unë ëndërrojmë t'i japim fund karrierës së bashku

MIAMI, 31 KORRIK - "Pleshiti" Lionel Messi kaloi me shumë bujë tek amerikanët e Inter Miami të këtë merkato vere teksa pas tij u afruan gjithashtu edhe dy "katalanas" të tjerë, Sergio Busquets e Jordi Alba, mirëpo duket se nuk përfundon me kaq, pasi një ribashkim me 7 herë fituesin e "Topit të Artë" e kërkon dhe "bomberi" uruguian Luis Suarez. Për media, Suarez, i cili tashmë luan te brazilianët e Gremios, është shprehur se ai dhe Messi ëndërrojnë t'i japin fund karrierës së tyre në të njëjtën kohë e të njëjtën ekip, duke lënë të nënkuptohet se kërkon një transferim në MLS. "Messi dhe unë ëndërrojmë t'i japim fund karrierës së bashku. E kemi planifikuar teksa



luanim te Barcelona, por më pas unë u transferove tek Atletico Madridi, ndërsa ai iku te PSG. Ëndërruam dhe folëm për faktin që pas Barcelonës do të shkonim në ShBA, por kjo nuk ndodhi. Tani ai

ka vendosur të shkojë atje. Siç mund ta shihni, Messi duket i lumtur. Shpresojmë që në një moment të ketë një mundësi për të luajtur për një klub më shumë", ka thënë Suarez.

### SHKURT

#### Nuza drejton ndeshjen Luzern - Djurgarden

Gjyqtarët kosovarë edhe këtë mesjavë do të jenë të angazhuar në garat evropiane. Në fakt, UEFA ia ka besuar gjyqtarit autoritativ Genc Nuza ndarjen e drejtësisë në ndeshjen tejet të rëndësishme të kthimit për rrethin e dytë të Ligës së Konferencës ndërmjet skuadrës zvicerane Luzern dhe asaj suedeze Djurgarden. Ndeshja e parë është fituar 2:1 nga skuadra zvicerane, e cila ishte mysafire, teksa përballja e kthimit do të zhvillohet më 3 gusht në "Luzern Arena", me fillim prej orës 20:45. Nuzës do t'i asistojnë Bujar Selimaj dhe Arbnor Bullatovci, ndërsa gjyqtar i katërt është Burim Jahmurataj.

#### Kosova në FIBA 3x3 U23 Nations League në Hungari

Kosova do të garojë në FIBA 3x3 U23 Nations League në Szolnok të Hungarisë. Kjo do të jetë hera e dytë që Kosova do të garojë në këtë ligë, pasi më herët ishte organizuar në Prishtinë. Kjo garë do të zhvillohet nga 1 deri më 3 gusht. Për Kosovën te meshkujt do të garojnë: Bardh Rexha, Donat Rexhepi, Drilon Shala dhe Mirlind Zekaj, kurse te femrat Agnesa Rrahmani, Besjana Martinaj, Erjona Krasniqi dhe Sara Vraniçi. Ashtu si edhe në Prishtinë do të garojnë Gjermania, Holanda, Hungaria, Greqia, Turqia dhe Kosova në të dyja konkurrencat. Formati është i ngjashëm me turneun në Prishtinë, ku Kosova do të luajë në grupe, ndërsa për tri ditë do të zhvillohet finalja te meshkujt dhe femrat.

#### Simeone: Jam i kënaqur, mora përgjigjen që desha nga skuadra

Atletico Madridi triumfoi në miqësore ndaj Manchester Cityt (2-1). Trajneri i "Los Colchoneros", Diego Simeone, është shprehur i lumtur me paraqitjen e skuadrës së tij. "Një skuadër si e jona është karakterizuar gjithnjë nga qetësia. Mos të harrojmë se ndeshjen e kaluar u mposhtëm nga skuadra e yjeve të Koresë së Jugut. Nga sfida me Cityn jam i lumtur nga përgjigjja që mora nga futbollistët që u aktivizuan në pjesën e dytë. Na duhet një grup shumë i fortë. Më duhen lojtarë të cilët futen me shumë energji në fushë në mënyrë që ta ndryshojnë rrjedhën e lojës", ka thënë Simeone.

#### Pensionohet Diego Godin

Edhe një tjetër legjendë e futbollit evropian e kryesisht La Ligas i ka thënë lamtumirë futbollit. Bëhet fjalën për ish-qendërmbrojtësin e Atletico Madridit, Interit, Villarrealit e Cagliariarit, Diego Godin, me uruguianin i cili të dielën mbrëmë ka zhvilluar përballjen e fundit në karrierë si futbollist profesionit, me skuadrën e tij Velez Sarsfield që u përball me rivalët e Huracanit. Me një karrierë të pasur me plot arritje, Godin ka arritur të zhvillojë plot 626 përballje në karrierën e tij, ku ka arritur të shënojë 38 gola e të dhurojë 23 asistime, si dhe ka arritur të fitojë tri herë Superkupën e Evropës, dy herë Evropa Ligën, një trofe të La Ligës, një Copa del Rey, një Superkupë të Spanjës, 1 Superkupë të Brazilit dhe Kupën e Amerikës me Kombëtaren e Uruguait. Ndërkaq, kujtojmë se pas largimit nga futbollit evropian në janarin e vitit 2022, ku u transferua te brazilianët e Atletico Mineiros, 37-vjeçari qëndroi vetëm 6 muaj në elitën e futbollit brazilian për t'u transferuar më pas tek argjentinasit e Velez Sarsfieldit, aty ku e mbylli karrierën.

## Qeveria ukrainase lejon sportistët e saj të luajnë ndaj atyre rusë e bjellorusë, por me një kusht

Kur duhet edhe një vit që të nisnin Lojërat Olimpikë "Paris 2024" (26 korrik) Qeveria e Ukrainës ka miratuar një dekret, ku i lejon dhe u kërkon sportistëve të saj të mos bojkotojnë eventet apo sfidat ndaj sportistëve apo ekipeve

nga Rusia e Bjellorusia. Gjatë 18 muajve të fundit, që kur nisi lufta në Ukrainë, ka pasur mjaft përplasje në sport mes sportistëve nga këto shtete e jo vetëm. Gjithsesi, qeveria ukrainase ka një kusht, që sportistët rusë e bjellorusë në

këto evente të jenë si sportistë neutralë e jo të garojnë nën flamurin e vendit të tyre. Bojkoti do të jetë në fuqi nëse sportistët rusë e bjellorusë do të garojnë për flamurin e vendit të tyre apo nën simbole provokuese, që përfaqësojnë

këto dy shtete. Pak kohë më parë edhe Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) lejoi sportistët rusë e bjellorusë të garojnë në eventet kualifikuese për Olimpiadën e vitit të ardhshëm, por si neutralë. Qeveria e Ukrainës po ndjek po

këtë linjë, të IOC, në mënyrë që të sigurojë sa më shumë sportistë të kualifikuar për në Olimpiadë. Prej kohësh kanë nisur eventet kualifikuese dhe ka pasur mjaft përplasje mes sportistëve të këtyre shteteve, që kanë krijuar edhe polemika.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Hey food FA&VH” Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811998163 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Hey food FA&VH” D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811998163 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “Hey food FA&VH” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 811998163 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 31.07.2023 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qira.

**Shpallje Publike**

**T-23-10**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave, repartit të Zallitjes në FPP  
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë  
Data e shpalljes: 31.07.2023  
Sqarimi: deri me 15.08.2023  
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 15.08.2023  
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e shitjes.  
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)  
Afati i fundit i dorëzimit: 16.08.2023 në 11:00  
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes në Trepça Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>hajdini_b@hotmail.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcash.com</i>		

**Njoftim për zvogëlim kapitali**

Pronarët e biznesit "JARA HOME" SHPK, magjistrerja MITROVICË me numër unik identifikues: 811359282, z. VALON FEJZULLAHU vendosi që të bëj zvogëlimin e kapitalit vlera e regjistruar 300 mije euro në kapitalin 10 mijë euro.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Teuta Dervish Ruzhaja shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë.
- “OSK Brokers” SH.P.K. me NUI: 811995383 Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

